

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.30 Regj. Themeltar, Datë 09.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

I paditur: Komisionit Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.175, datë 06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

1. Rinumërimin dhe Rivlerësimin e drejtë të votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh, duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i drejtë i votave;
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh;
3. Ndryshimin e Vendimit të KSHZ nr.533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke pasqyruar ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatit e qendrës së votimit nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë; si dhe
4. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Më datë **12.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

1. **Sokol Ibi (Relator);**
2. **Manjola Xhaxho (Anëtare);**
3. **Marsela Dervishi (Anëtare);**
4. **Alma Kolgjoka (Anëtare);**
5. **Emona Muçi (Anëtare).**

Me Urdhër datë 13.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **15.06.2023, ora 15:30**, për zhvillimin e seancës gjyqësore.

Lidhur me ambientin e zhvillimit të seancës gjyqësore, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor caktoi **Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rr.“Ismail Qemali”, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë**, në kushtet kur prej njoftimeve të datave 12.06.2023 dhe 13.06.2023, në grupin e

gazetarëve në aplikacionin ËhatsApp, nuk pati asnjë konfirmim për pjesëmarrje në seancë, çka do të diktonte zhvillimin e seancës në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Tiranë, më 14.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë